

LIGJ
Nr. 19/2018

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, REPUBLIKËS SË FRANCËS DHE KOMISIONIT EVROPIAN PËR PROGRAMIN INTERREG V-B MESDHE (MED) 2014 – 2020

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Francës dhe Komisionit Evropian për programin Interreg V-B Mesdhe (MED), 2014–2020, sipas tekstit bashkëlidhur këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 5.4.2018

Shpallur me dekretin nr. 10771, datë 23.4.2018 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,

Ilir Meta